



## KUVENDI I KOMUNËS

**Procesverbal nga mbledhja e XXIII-të (njëzetetë)-e jashtëzakonshme, mandati VII-të, e mbajtur më 10 mars 2023.**

***E thirrur në kërkesë të Kryetarit të Komunës, duke përcaktuar edhe pikat e rendit të ditës.***

Mbledhja filloi në orën 10;20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

(Nga LDK Valon Demolli; Demokrat Hodolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Adnan Zymeri; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani, mungoi Ilir Koprani.

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi, mungoi Drita Pajaziti.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Endritë Murati; Mimoza Abdullahu. Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi)

Gjithashtu i pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Pajtim Balaj-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Fatmir Rudari-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE;

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues (tre) të KFOR-it, përfaqësues të mediave lokale dhe më gjerë si dhe disa zyrtar komunal, përfshirë edhe komisionin komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

### Rendi i Ditës

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë, ndër të tjera theksoi, kuorumi ekziston, në sallë prezent për momentin janë 32 anëtar/e të Kuvendit kurse mungojnë 3 anëtar/e të Kuvendit.

Kjo mbledhje e jashtëzakonshme është thirrur me kërkesë të Kryetarit të Komunës z.Shpejtim Bulliqi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë me kohë dhe jeni informuar rreth pikave të rendit të ditës, andaj pa humbur kohë e vë në votim, kush jeni që të vazhdohet me punime sipas këtij rendi të ditës.

*Njëzëri nga të pranishmit u mbështet që të vazhdohet me këtë mbledhje sipas thirrjes përkatëse.*

## **1. Raporti përfundimtar i Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, në mbledhjen e kaluar të jashtëzakonshme është diskutuar rreth gjendjes së vërshimeve në Komunën e Podujevës, që nga ajo ditë e deri sot komisioni komunal ka punuar në këtë drejtim dhe ka bërë verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe tani e ka sjellë një listë që përmban të dhënat e dëmeve të shkaktuara dhe koston e tyre.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, ashtu siç kemi diskutuar më herët, madje edhe në seancën e kaluar që ishte e jashtëzakonshme, jemi njoftuar për gjendjen e vërshimeve të datës 19 janar 2023 në Komunën tonë, edhe atëherë e kemi cekur që komisioni është duke punuar në vlerësimin e këtyre dëmeve, andaj ju njoftoj se komisioni ka përfunduar këtë vlerësim dhe ne me kërkesë të Ministrisë jemi të obliguar që këtë raport ta paraqesim para jush në mënyrë që të marrim vendim në Kuvend, pastaj këtë vendim ta dërgojmë në organet kompetente që merren me vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet.

Nga data 19 janar 2023 e deri më sot komisioni për vlerësimin e dëmeve ka punuar rregullisht me një intensitet të lartë dhe përkushtim të madh në punë, me ç'rast unë i falënderoj të gjithë që sot janë këtu me ne prezent, për punën dhe angazhimin që kanë bërë, dhe në fund kanë dalë me një raport përfundimtar të detajuar i cili juve u është dërguar me thirrjen e kësaj seance e shpresoj të keni pasur kohë dhe mundësi që ta shfletoni këtë raport dhe të njiheni për së afërmi me të gjitha dëmet dhe vlerësimet që janë bërë në Komunën tonë. Pra materialin e keni marrë me kohë dhe në pika të shkurtra po i ceku disa kategori për të cilat është bërë vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga vërshimet si në ekonomitë familjare, bujqësi dhe infrastrukturë, ndërsa sa i përket kategorisë së bizneseve, ato kanë hyrë në bazë të kërkesave të bizneseve, varësisht sipas vlerësimit të dëmeve të shkaktuara ose te ekonomitë familjare ose te bujqësia, fjala është për dëmet e shkaktuara në biznese sepse këtu si kategori nuk e kemi vlerësuar ndaras për arsye se kërkesat kanë qenë individuale dhe mandej është dashur të bëhet vlerësimi individual, por gjithsesi edhe ato dëme janë të përfshira në këtë raport.

Janë vlerësuar dëmet në 142 ekonomi familjare në vlerë totale 296,970.50€, në bujqësi janë vlerësuar 144 prona të dëmtuara në vlerë 355,605.97€, kurse në infrastrukturë kemi dëme dukshëm më të mëdha në vlerë prej 2,257,969.30€, pra vlera totale e dëmeve arrin 3,189,905.86€ dëme të cilat janë të listuara në listat që ju i posedoni.

Sa i përket listës së ekonomive familjare më duhet t'ju kërkoj falje në emër të komisionit sepse është bërë një gabim teknik ngase në listat që u janë dërguar juve mungojnë 6 emra të ekonomive familjare, pra gabimi është teknik dhe atë gjatë shtypjes së listës, mirëpo tani propozoj dhe kërkoj që lista në fjalë të plotësohet edhe me 6 emra që kanë pasë dëme në ekonomi familjare, dhe atë Hyra Fazliu-fshati Brecë, Besim Zeneli-fshati Pakashticë e Epërme, Sofie Mehana-fshati Peran, Isak Abazi-fshati Bradash, Mirsim Aliu-fshati Pakashticë e Epërme dhe Naim Çunaku-fshati Llugë, kurse ndryshime tjera nuk ka në listën e dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje për dëmet e shkaktuara në ekonomitë familjare, përveç emrave të cekur së bashku me vlerën shtesë prej 4,219.00€ e cila tani natyrisht se e bënë edhe ndryshimin e vlerës totale të vlerësimeve të dëmeve në ekonomi familjare dhe në tërësi si vlerë e përgjithshme.

Në bujqësi lista e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet nuk është aq e madhe, ndërsa ashtu siç e keni parë dëmet më të mëdha janë shkaktuar në infrastrukturë dhe këto dëme ne i kemi cekur dhe po i cekë sërish sepse ka pas dëmtim të urave në fshatrat Majac dhe Sfeçël, dëmtim të rrugëve në fshatin Pakashticë, dëmtim të kanalizimeve fekale dhe atmosferike, gjithashtu kemi pas dëmtime të brigjeve të lumenjve në një kosto më të madhe se sa dëmtimet tjera.

Unë nuk dua t'ju marrë kohë më shumë sepse të gjithë e keni marrë materialin dhe besoj që të gjithë e keni shfletuar me kohë dhe ndoshta dikush nga ju ka për të thënë diçka, prandaj ju falënderoj shumë për

pjesëmarrje në këtë seancë sot dhe nga ju kërkoj që bashkërisht ta votojmë këtë raport në mënyrë që të hapim rrugë për të bërë kompensimin e këtyre dëmeve në mënyrë që komisioni qeveritar ta ndajë atë shumë të mjeteve buxhetore në një përqindje të caktuar dhe të fillojmë me kompensimin e këtyre dëmeve. Realisht afati i fundit për votim të këtij raporti është sot, andaj për këtë arsye është thirrur edhe kjo mbledhje e jashtëzakonshme.

**z.Valon Demolli**, theksoi, sa i përket raportit përfundimtar të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Grupi i këshilltarëve të LDK-së tregoi përkushtim për trajtimin serioz të këtij shqetësimi qytetarë, dhe për këtë më datë 14 shkurt 2023 kemi thirr seancë të jashtëzakonshme për këtë çështje. Me të vërtetë ne i ndjejmë këto fatkeqësi dhe kërkuam që kjo temë të trajtohet sepse këto ishin shqetësime të qytetarëve dhe ne në atë seancë kërkuam ndarjen e mjeteve buxhetore që sa do pak t'i zbusim dëmet e shkaktuara qoftë në ekonominë familjare, biznese apo ato në bujqësore, mirëpo për habi Kryesuesi i Kuvendit propozimin nuk e hodhi në votim dhe e injoroi atë, e që me të vërtetë është për keqardhje edhe pse nuk është hera e parë që ndodh kjo, andaj mund të them se këto defekte janë bërë normale tash më në Kuvendin tonë.

Sot na gëzon fakti që më në fund na erdhi raporti përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve, andaj Grupi i këshilltarëve të LDK-së e mbështet këtë raport me të vetmin qëllim që të bëhet kompensimi i dëmeve të shkaktuara nga vërshimet.

Për fund, paraqesim shqetësimet tona pasi që ky komision nuk ka përbërje të anëtarëve të Kuvendit dhe ne nuk kemi pasur qasje sa i përket vlerësimit të dëmeve të shkaktuara, uroj që ta keni bërë vlerësimin e duhur e jo për favore dhe ngjyrimet politike.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa për sqarim për mbledhjen e kaluar ju njoftoj se diskutimi nuk hedhet në votim sepse mbledhja është thirrur për diskutim, prandaj ne kemi vepruar sipas ligjit dhe nuk kemi pasur qëllime tjera, ky ishte një sqarim.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, e dëgjova drejtorin e DSHPMSh që i ceku 6 emrat e ekonomive familjare të dëmtuara kinse më parë nuk ka pas mundësi ta përgatis listën, por del tregon kinse edhe njëherë arsyen e mos përfshirjes së tyre, mirëpo qëllimi i tij ishte tjetër, prandaj qëllimisht u ceken ata emra të asaj liste, të paktën që ta qet dikën në pozitë të keqe, andaj nuk pati nevojë të bëjë këtu “skena e filmi” sepse ka pasur mundësi që ata emra të atyre ekonomive familjare të na i dërgojë me shkresë, e jo të dal në foltore e ta cek secilin emër të secilës ekonomie familjare veç e veç.

**z.Haki Rudari**, theksoi, muaji janar është karakterizuar me disa vërshime që për qytetarët këto vërshime kanë qenë të dëmshme por në të njëjtën kohë organet komunale kanë marrë disa iniciativa që sa do pak atyre qytetarëve të prekur nga vërshimet t’ju dalim në ndihmë.

Komisioni për vlerësimin e dëmeve sipas informatave që kam është në përbërje prej 5 anëtarëve e që 3 prej tyre komisioni janë nga 1 prej Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbroje dhe Shpëtim dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Realisht shuma e dëmeve të shkaktuara prej 3,185, 686.00€ është një shumë që ka dalë nga komisioni i cili ka bërë hartimi dhe rregullimin e gjithë dokumentacionit.

Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë raport, por në të njëjtën kohë ne nuk kemi mundur të ndajmë mjete buxhetore pa i ndarë nivelin qendror njësoi si në komunën tonë ashtu edhe në komunat tjera të Republikës së Kosovës gjatë asaj kohe që ka pasur vërshime.

Vetëm edhe një çështje dua ta sqaroj, janë disa shuma në vlerë 13,000.00€; 20,000.00€; 70,000.00€, etj, andaj nëse ka mundësi dikush nga komisioni të na tregoj për parametrat që kanë arritur këto shuma për dëmet e shkaktuara nga vërshimet.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, Grupi i këshilltarëve të PDK-së e përkrah raportin e komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

**z.Burim Hasani**, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të AAK-së, e mbështesim këtë raport përfundimtar të komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera, dhe njëkohësisht e përhëndesim edhe punën dhe angazhimin e komisionit që ka bërë në këtë periudhë kohore.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSh, tjera theksoi, mora fjalën duke parë insistimin e asamblistit z.Ekrem Rrahmani sa i përket leximit të atyre emrave, e që sipas del sikurse të ishin listat sekrete, pra nuk ka listë sekrete, listën e keni të gjithë dhe emrat tjerë janë në listë. E përsërisë se është gabim teknik andaj ne me apo pa dashje duhet t'i cekim ata emra sepse nuk kemi pasë mundësi t'ju dërgojmë edhe njëherë materialin për shkak të afatit kohor që është i përcaktuar sipas ligjit, prandaj mos u shqetësoni për këtë gjë sepse gjithçka është transparente dhe e dukshme. Kushdo apo cili do që të jetë do të trajtohet njësoj sepse së fundmi të gjithë jemi qytetarë, andaj nuk kemi pasë asnjë tendencë apo qëllim që ta qesim keq dikë, madje unë paraprakisht bisedova me të (*fjala është për anëtarin e Kuvendit z.Naim Çunaku*) dhe kjo është arsyeja përse ai nuk është këtu prezent sepse nuk ka të drejtë të marrë pjesë në votim për shkak të konfliktit të interesit, prandaj mendoj se nuk është turp të paraqiten dëmet e shkaktuara nga kushdo qoftë, madje nëse do të më shkakttoheshin edhe mua, do t'i paraqisja.

**z.Ekrem Rrahmani**, i drejtohet drejtorit të DSHPMSh, theksoi, ju e dini se ku e kam shtëpinë unë, dhe kjo është arsyeja pse ju dilni e bënë skena filmi këtu, unë asnjëherë nuk bëjë kërkesë për kompensim të dëmeve edhe nëse e tërë shtëpia ime shembet nga vërshimet, asnjë cent nuk e marrë si kompensim dëmi, përsëri do e rindërtoj të re, mirëpo nuk ka nevojë të dilni e të deklaroni se i kemi harruar apo nuk i kemi përfshi 6 ekonomi familjare në listën e raportit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore sepse nuk ka pasur nevojë ta bëni këtë ngase keni mundur ta bëni përmes e-mailit e që e gjithë kjo do të zgjaste vetëm një minutë, prandaj nuk ke pas nevojë me humb kohë sepse deri sa ke dalë në foltore këta emra ishin ardhë përmes e-mailit, por pate qëllime tjera.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, i nderuar unë po u japë një sqarim si Kryesues i Kuvendit, çdo ndryshim që bëhet pasi të dërgohet materiali i mbledhjes nuk mund të vije pas 3 ditëve të punës në këtë rast, për atë arsye çdo ndryshim duhet të përmendet në Kuvend që të kontrollohet dhe të verifikohet sepse në ditën e nesërme që është dërguar thirrja dhe materiali është vërejtur ky gabim, andaj po ta ridërgonim sërish thirrjen dhe materialin atëherë nga ana e Ministrisë përkatëse do të anulohet kjo mbledhje për shkak të shkeljeve të procedurave dhe afateve ligjore, këtu është problemi, sepse nuk dua të kemi pengesa ligjore. Urdhëroni nëse ndokush nga ju dëshiron ta marrë fjalën, nëse jo atëherë e vë në votim raportin përfundimtar të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, përfshirë edhe plotësim ndryshimin e listës përkatëse sipas propozimit të drejtorit të DSHPMSh në fjalën hyrëse, për plotësim ndryshimin e listës, përkatësisht përfshirjen edhe të 6 personave që kanë pësuar dëme në ekonomi familjare.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 31 vota Për, miratohet Raporti përfundimtar i Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, përfshirë edhe plotësim ndryshimin e Listës përkatëse të propozuar nga drejtori i DSHPMSh në fjalën hyrëse, përkatësisht përfshirjen e 6 personave të cilët kanë pësuar dëme por që nuk janë përfshirë në listë si shkak i një gabimi teknik.*

*Personat që përfshihen në list janë: Hyra Fazliu-fshati Brecë, Besim Zeneli-fshati Pakashticë e Epërme, Sofie Mehana-fshati Peran, Isak Abazi-fshati Bradash, Mirsim Aliu-fshati Pakashticë e Epërme dhe Naim Çunaku-fshati Llugë, dhe atë sipas vlerësimeve të bëra nga Komisioni përkatës me ç'rast ndryshon edhe vlera totale e vlerësimit të dëmeve.*

*(Në këtë pikë të rendit të ditës, duke përfshirë edhe votimin, prezent nuk ishte anëtari i Kuvendit z.Naim Çunaku, dhe kjo për shkak të konfliktit të mundshëm të interesit meqë u propozua të jetë pjesë e listës së bashku me 5 të tjerë)*

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, i nderuari Kryesues, kolegu ynë z.Haki Rudari paraqiti një kërkesë për komisionin komunal sa i përket disa shumave të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, mirëpo nuk morëm ndonjë përgjigje apo ndonjë sqarim konkret lidhur me ato shuma.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa i përket kësaj që parafolësi e ceku, komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve e ka përfunduar punën e tij dhe ka bërë evidentimin e dëmeve të shkaktuara dhe e ka nënshkruar listën, ne mundemi vetëm ta votojmë ose jo atë listë. Askush nga komisioni nuk e ngriti dorën që të bëjë sqarime rreth pyetje së kolegut z.Haki Rudari.

**z.Fatmir Rudari**, drejtor i DBPZHR, theksoi, unë vetëm desha t'ju njoftoj me mënyrën se si është bërë vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si pasojë e vërshimeve.

Sipas njoftimit paraprak nga komisioni, llogaritjet janë bërë në bazë të kartonit apo raportit të gjelbër që e ka ofruar Ministria e Bujqësisë, pra ju është sjellë nga Ministria një format në excel dhe detyrë e komisionit ka qenë të shkruhet numri i parcelave dhe përqindja e dëmit të shkaktuar nga vërshimet dhe automatikisht sipas programit excel ka dalë shuma e dëmit të shkaktuar. Pra gjithçka ka qenë e gatshme, kurse ne vetëm e përgëzojmë komisionin që kanë vizituar çdo familje të dëmtuar nga këto fatkeqësi natyrore dhe kanë bërë vlerësimin e dëmeve të tyre prandaj besoj se gjithçka ka qenë transparente edhe pse mund të duken disa shuma se janë të fryra, por ato shuma janë kalkuluar në bazë të sistemit të Ministrisë përkatëse.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, falënderoj drejtorin parafolës për këto sqarime. Kjo pikë përfundoj dhe u votua por meqë u kërkuan sqarime shtesë dhe u jepen, andaj kalojmë në pikën e radhës.

## **2. Rishqyrtimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023 - 2025**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025, nga ana e Ministrisë përkatëse është kthyer në rishqyrtim dhe afati është brenda 30 ditësh, dhe atë për shkak të disa defekteve teknike që janë paraqitur në dokument, kështu që Strategjia është kthyer sërish me përmirësime, andaj për sqarime shtesë fjalën ia kaloj drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

**z.Vigan Salihu**, drejtor i DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, në mbledhjen e mbajtur në muajin dhjetor të viti 2022, është miratuar Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025 dhe pastaj ky dokument ka vazhduar tutje në procedurat e shqyrtimit të ligjshmërisë në MAPL, dhe si rrjedhojë më datë 09.02.2023 kemi pranuar një shkresë për rishqyrtim me disa rekomandime. Ne DPZHE dhe kompania e kontraktuar për hartimin e dokumentit në fjalë, kemi harmonizuar gjitha rekomandimet dhe njëkohësisht kemi marrë konfirmim paraprak që dokumenti është komform kërkesave dhe rekomandimeve të bëra nga ana e Ministrisë, dhe tani ky dokument është i kompletuar dhe vetëm kërkohet miratimi nga Kuvendi.

**z.Adnan Zymeri**, theksoi, tashmë të gjithë jemi dëshmitar që ta shqyrtosh një akt ligjor në Kuvendin e Komunës së Podujevës është e çuditshme, ndërsa nuk është çudi që për çdo seancë ta shqyrtojmë akte të jashtëligjshme dhe e gjitha kjo ndodh se komuna udhëhiqet nga një Ekzekutiv ku pjesa dërmuese e tij janë njerëz që punën e parë në jetë e kanë postin e drejtorit. Edhe drejtor i mirë edhe “yes-man” nuk shkojnë në një vend.

Sa i përket temës së Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik, në mbledhjen e mbajtur më datë 09.12.2022 në Kuvendin e Komunës së Podujevës gjatë shqyrtimit të kësaj pike e kam potencuar që para hartimit duhet të mendohet për implementimin e dokumentit, siç është ky dokument mjaft i rëndësishëm, kurse tani del të jetë i pa zbatueshëm ngase është i hartuar dhe i kopjuar keq në të njëjtën kohë.

Po e citoj edhe një pjesë të diskutimit tim nga seanca e datës 09.12.2022, dhe atë, ....*mirëpo as vizioni e as misioni nuk jetësohet pa objektiva të qarta, për të përcaktuar objektiva të qarta ato duhet të jenë smart, specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe në kohë, asnjë nga objektivat specifike të qëllimeve strategjike nuk i përmbajnë këto elemente, elemente të cilat do t'i shndërronin këto objektiva nga objektiva sa për sy e faqe në objektiva të realizueshme, shembull, zhvillimi dhe përmirësimi i ambientit e të bërit biznes thuhet se do të bëhet pa specifikuar numrin e ndërmarrjeve që do të subvencionohen, periudhën kohore, kapacitetet e mbulueshmërisë, ndërsa nxitja për eksport është planifikuar të bëhet vetëm duke hartuar listën e eksportuesve dhe atë deri në vitin 2025.....*

Të njëjtat vërejtje për metodologjinë e hartimit janë dhënë edhe në arsyetimin e Ministrisë, pavarësisht se bujqësia është nga degët kryesore të ekonomisë, nga hartues i listës së mëshqerrave në sponsorizues të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal, është goxha kapërcim i madh.

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal, një dokument ky i cili qytetit tonë i ofron një rrugë të qartë drejt zhvillimit ekonomik.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës dhe arsyeshmërisë së saj, u munduat të bëni një arsyetim se në këtë dokument janë bërë disa gabime teknike, mirëpo ne ju themi se ato gabime nuk janë teknike por janë përmbajtjesore. Drejtorit të DPZHE i them të bëhet më serioz dhe të dal të bëjë sqarime e jo të qeshet sepse herën e kaluar ky dokument nuk është i hartuar mirë, kurse ai deklaronte se dokumenti është në rregull, madje duke theksuar se ne e kemi gabim atë e themi, madje duke e ditur se Grupi i këshilltarëve të LDK-së përbëhet prej 7 super ekonomistëve, e të cilët i kanë paraqit mangësitë e dokumentit. Është bërë e tepërt që për çdo mbledhje të Kuvendi, nga MAPL kthehen vendime jo ligjore, është një zyrë ligjore dhe mund të konsultohuni me të, prandaj të mos dalim keq si Kuvend.

Ne nuk votojmë për inati këtu, por kur nuk votojmë diçka ne i japim edhe arsyetimet tona sepse nuk kemi ardhur këtu të kundërshtojmë gjithçka, mirëpo duhet të bisedojmë dhe të konsultohemi për secilën çështje mes veti sepse edhe pse jemi opozitë, ne ju ndihmojmë për gjithçka.

**znj.Mimoza Abdullahu**, theksoi, Grupi i këshilltarëve të PDK-së e përkrahim rishqyrtimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal në Komunën e Podujevës për periudhën kohore 2023-2025.

**z.Vigan Salihu**, drejtor i DPZHE, theksoi, fillimisht e them se nuk e kam për replikë por nuk është mirë të lëshohemi në ofendime, prandaj nuk kisha dashur që të eskaloj debati e të lëshohemi në ofendime. Rekomandimet e Ministrisë kanë qenë më shumë teknike, madje të bazuara në një Udhëzim Administrativ i cili rregullon krejt një çështje tjetër, atë dokumenteve strategjike të nivelit qendror, jo atë të nivelit lokal, mirëpo pavarësisht kësaj ne ju kemi përmbajtur atyre rekomandimeve dhe e kemi harmonizuar dokumentin në fjalë të cilin tani e keni para vetës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, ditë kur është miratuar Strategjia Zhvillimore, theksin e diskutimit tim e bëra tek afatet kohore dhe objektet specifike dhe në fund e përmbylla me një thënie se ky dokument është një fontanë dëshirash dhe se do të jem personi më i lumtur nëse ky dokument do të realizohet.

Një dokument si Strategjia Zhvillimore e Komunës do të thotë një diçka që i paraprinë dhe e bënë të ardhmen zhvillimore të komunës, vërtetë sipas Udhëzimit Administrativ e kemi pas një propozim për hartimin e strategjisë zhvillimore të nivelit lokal dhe e kam bindjen se ai që ka marrë pjesë në këtë proces po ta kishte marrë mundin e t'i lexojë 22 faqe të këtij dokumenti, sigurisht se ky dokument nuk do të vinte për rishqyrtim.

Nuk mund të hartosh projekte e ta përjashtosh atë për të cilin bëhet projekti, e në këtë rast kur projektet kapitale dhe projektet zhvillimore të komunës mundet një individ për tekun e tij të marrë veprime për realizimin e ndonjë projekti që e sheh si të çmuar për vendin dhe komunën e tij. Mirëpo për të qenë Strategjia apo një dokument i qëndrueshëm, nuk e di a jemi duke shpërfillur apo nuk po mund të gjejmë mekanizma për ta ofruar qytetarin në vendimmarrje, e them këtë sepse Strategjia në fjalë, projektet kapitale etj të ngjashme, nuk mund të kalojnë pa miratimin dhe konsultimin me qytetarët.

Në këtë Strategji nuk e kemi pasë pjesën e debateve dhe nuk kemi parë edhe qytetarët se çka dëshirojnë në zhvillimin e komunës për 5 vitet e ardhshme, andaj me vetë faktin që kjo Strategji është kthyer në rishqyrtim nga ana MAPL si jo ligjore, flet mjaftueshëm dhe po t'i marrësh e t'i krahasosh datat se kur është kthyer ky dokument, dhe të sjellët ky dokument për rishqyrtim në një seancë të jashtëzakonshme, sërish flet sa serioz jemi ndaj Strategjisë Zhvillimore të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nëse ndokush dëshiron ta marrë fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025, në procedurë të rishqyrtimit sipas Shkresës së Ministrisë së Pushtetit Lokal nr.020-1131/4 e datës 09.02.2023.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 32 anëtarë/e sa ishin prezent në sallë, me 19 vota Për, 13 vota Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur, me vendim miratohet Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023 – 2025, në procedurë të rishqyrtimit sipas Shkresës së Ministrisë së Pushtetit Lokal nr.020-1131/4 e datës 09.02.2023.*

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, para se ta përfundojmë këtë mbledhje, kam një sqarim për ju anëtar të Kuvendit, të nderuar si jemi në dijeni Ligji i ri i pagave ka hyrë në fuqi dhe sipas tij kërkohet definimi i vendeve të punës, andaj të gjithë ata që punojnë në sektorin e arsimit dhe të shëndetësisë kërkoj që pas kësaj mbledhje të vijnë në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendi dhe të konsultohemi paksa rreth definimit të pagës ashtu siç e parash Ligji për pagat në sektorin publik.

Po ashtu jua rikujtoj se afati kohor për deklarimin e pasurisë për anëtarët e Kuvendit të Komunës është deri më datë 31.03.2023.

*Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 10:55**

**Procesverbalin e mbajtën;**

**Enis Sheholli**

**Osman Bajrami**

**Nr.prot.01-060/04-0018811/23**

**Podujevë,**

**10 mars 2023**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Hilmi Hoxha**